



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0838

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 e amendamentuar me datën 09. 08. 2023, në përbërjen nga Vjosa Gradinaj-Mexhuani Kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE "Bek Fluids" L.L.C., kundër Vendimit për dhënie të kontrats lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me lëndë djegëse -Pelet" me numër të prokurimit 615-23-6669-1-1-1, të Komunës së Podujevës në cilësi të Autoritetit Kontraktues (AK), më 01/12/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE "Bek Fluids" L.L.C, me nr. 2023/0838 e datës 26/10/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me lëndë djegëse -Pelet", me numër të prokurimit 615-23-6669-1-1-1, inicuar nga Komuna e Podujevës, në cilësi të autoritetit kontraktues.
2. Mbetët në fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e sipërcituar.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Komuna e Podujevës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 30.06.2023, ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me lëndë djegëse Pelet", me numër të prokurimit 615-23-6669-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontrata kornize, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 144,000.00 €.

KK Podujevë (AK) me datën 18. 09. 2023, ka publikuar vendimin B 58 për dhënie të kontratës, me të cilin ka rekomanduar për dhënie GOE "Gëzime Gashi" B.I & N.P.T "Meti Commerce-Jakup

Ferri”.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, OE “Bek Fluids” me dt. 25.09.2023 kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim, të cilën AK me datën 16. 10. 2023 e ka refuzuar.

Me 26.10.2023, OE “Bek Fluids” kundër vendimit të cituar si më sipër, ka parashtruar ankesë në OSHP (Nr. Protkollit 838/23).

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak

OSHP ka konstatuar se ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor sipas nenin 109 paragrafin 1 të LPP, pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

-Administrimi dhe vlersimi i provave-

Pretendimet e OE “Bek Fluids” L.L.C në ankesën e parashtruar në OSHP, Nr. 838/23

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi i LPP përcakton “7.1 Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Konsiderojmë se Komuna e Podujevës ka shkelur nenin 7 (diskriminimin) të LPP sepse ka diskriminuar Kompaninë tone duke propozuar me shpërblim për Kontrate OE i cili është me i shtrenjtë se sa oferta e kompanisë tone.
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve i LPP përcakton Pika 2- Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Konsiderojmë se Komuna e Podujevës ka shkelur këtë nen sepse ka propozuar për shpërblim me kontratë Operatorin ekonomik i cili nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat. AK mund të konsideron një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse përmban gabime ose paqartësi ose përmban vetëm devijime të vogla. Në rastin konkret oferta e OE shpallur fitues nuk ka përmbajtur vetëm devijime apo gabime të vogla për të shpallur i përgjegjshëm por OE nuk ka plotësuar kushtin kryesor që është Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët sepse konzorciumi jone ka çmimin me të ulët.
- Neni 60 “Kriteret për Dhënien e Kontratë” përcakton “Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Konsiderojmë se Komuna e Podujevës ka shkelur këtë nen sepse ka propozuar për shpërblim OE i cili ka dorëzuar tenderin me çmimin me të lartë. gjithashtu në njoftimin për vendimin e autoritetit kontraktues oferta e Konzorciumit “Bek Fluids” LLC dhe “DHF Company” SHPK është paraqitur në listë në vlerë prej 168,850.00 euro ndërsa oferta është 133,045.00 euro kjo tendencë e AK-se për të ndryshuar vlerat e ofertave është shumë shqetësuese.

- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë i LPP, përcakton Pika 1 “Kur informacioni apo 4/3 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës” Pika 3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Konsiderojmë se Komuna e Podujevës ka shkelur këtë nen sepse nuk ka kërkuar informata shtese nga OE edhe pse OE e kane dorëzuar listën e furnizimeve dhe në listë të furnizimeve janë të paraqitura të gjitha detalet e furnizimeve dhe vërtetohet se një dokument i tillë ka ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe sipas Nenit 72 AK e ka obligim që të kërkojë sqarime shtese dhe nuk ka kërkuar nga Operatorët Ekonomik sqarime shtese (d.m.th. nuk i ka kërkuar referencat edhe pse lista e referencave ka qene e bashkangjitur në ofertë).

Duke u referuar të pretendimeve si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60 dhe 72 të LPP.

Përgjigjet e AK-së në kërkesën për rishqyrtim të OE “Bek Fluids” L.L.C

- *Pretendimi ankimor i parë (I):* Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë i LPP, përcakton Pika 1 "Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës" Pika 3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Konsiderojmë se Komuna e Podujevës ka shkelur këtë nen sepse nuk ka kërkuar informata shtese nga OE edhe pse OE e kane dorëzuar listën e furnizimeve dhe në listë të furnizimeve janë të paraqitura të gjitha detalet e furnizimeve dhe vërtetohet se një dokument i tillë ka ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe sipas Nenit 72 AK e ka obligim që të kërkojë sqarime shtese dhe nuk ka kërkuar nga Operatorët Ekonomik sqarime shtese (d.m.th. nuk i ka kërkuar referencat edhe pse lista e referencave ka qene e bashkangjitur në ofertë.
- *Përgjigje ndaj pretendimit të parë (I) ankimor:* AK ka vlerësuar me kujdes ofertën e dorëzuar nga ana juaj dhe sipas listës së projekteve të realizuara dhe referencave të dorëzuar ju nuk keni prezantuar asnjë referencë ose kontratë për furnizim me pelet (lëndë e ngurtë), të gjitha referencat e prezantuara janë për furnizim me lëndë djegëse të lëngët (naftë) andaj ju nuk keni plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në vlerë jo më pak se 200,000.00 € në tre vitet e shkuara duke filluar nga data e publikimit njoftimit të kontratës.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16. 11. 2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore.

Lidhur me ankesën Nr. Protokolli 838/23 me datë 20.11.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar;
- Të mbetet ne fuqi vendimi i AK-së.

Lidhur me pretendimet e OE “Bek Fluids” L.L.C, ekspertja shqyrtuese përmes raportit Nr. 2023/0838 ka vlerësuar si në vijim:

- *Lidhur me pretendimin e parë (I):* “Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit, ku AK-përmes Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 18.09.2023 potencon tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshme dhe është refuzuar për këto arsye: “Ju njoftojmë se oferta e juaj nuk i plotëson dokumentet sipas kërkesës së AK-së në dosjen e tenderit ju mungojnë referencat e ngjashme ose ekuivalente.” Kundër njoftimit B58 njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues OE ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim. AK me datë 16.10.2023 nëpërmjet vendimit refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK-Komuna e Podujevës ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60, dhe 72 të LPP-së. Lidhur me pretendimin e OE ankues se është eliminuar pa të drejtë dhe kundërligjshëm nga ana e AK-së, autoritetit kontraktues ka propozuar për kontratë OE i cili është me i shtrenjte se oferta e tyre, po ashtu oferta e OE te rekomanduar për kontratë nuk është në përputhshmëri me te gjitha kërkesat, tutje OE ankues potencon se oferta e tyre është paraqitur në liste në vlerën prej 168,850.00 euro, ndërsa oferta është 133,045.00 euro kjo tendencë e AK-së për te ndryshuar vlerat e ofertave është shumë shqetësues. Po ashtu AK Komuna e Podujevës, ka shkelur edhe nenin 72 të LPP-së, duke mos kërkuar informata shtesë pasi kemi dorëzuar listën e furnizimeve dhe po në këtë liste janë paraqitur te gjitha detalet e furnizimeve dhe vërtetohet se një dokument i tillë ka ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderit. Ekspertja shqyrtuese, sqaron se AK ka kërkuar tek kërkesat 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në vlerë jo më pak se 200, 000.00 euro në tri vitet e shkuara duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës; dëshmi dokumentare: OE duhet të ofrojë listën të nënshkruar dhe të vulosur. Në listë duhet saktësuar, titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe mbarimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkangjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e punëve*”.
- *Lidhur me pretendimin e dytë (II):* “Ekspertja shqyrtuese, sqaron se operatori ekonomik ankues ka dorëzuar me tender dokumentin me titull ”Lista e Furnizimeve.pdf”, dhe dokumentin me titull Referencat.zip. Bazuar në listën e kontratave janë prezantuar gjithsej shtatë (7) kontrata në bazë të titullit të kontratave, të gjitha janë “Furnizime me lënde djegës”, po ashtu bazuar në referencat e lëshuar për këto kontratë të bashkangjitura nga OE ankues të gjitha referencat janë furnizime me naftë. Andaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar sepse autoritetit kontraktues ka kërkuar kontrata të ngjashme furnizim me lënde djegëse –Pelet, ndërsa bazuar në listën e kontratave dhe referencat lidhur me këto kontrata

rezulton se të gjitha këto kontrata janë furnizime me derivate të naftë”.

- *Lidhur me pretendimin e tretë (III):* “Lidhur me pretendimi e OE ankues se oferta e OE të rekomanduar për kontrata ka çmimin me të shtrenjtë, tutje OE ankues nuk ka specifikuar asnjë pretendim kundrejt ofertës se OE ankues por vetëm se ka çmimin me të shtrenjtë dhe është i pa përgjegjshëm, ekspertja shqyrtuese sqaron se përderisa AK gjatë vlerësimit të ofertave ka konsideruar se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesa e AK-së konform dosjes së tenderit, (ju mungojnë referencat e ngjashme ose ekujvalente) nuk ka mundur që të trajtoj tenderin e OE ankues si tender të përgjegjshëm me çmim më të ulët. “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit..... neni 59 par. 4 i LPP-së”.
- *Lidhur me pretendimin e katërt (IV):* “Lidhur me pretendimin e OE ankues se oferta e tyre në procesverbal e hapjes ka çmimin 133 045.00 euro, ndërsa në njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues ka çmimin prej 168,850.00 euro, OE ankues pretendon se kjo është tendencë e AK-së për të ndryshuar vlerat e ofertave dhe është shumë shqetësues. Ekspertja shqyrtuese lidhur me këtë pretendim ju ka drejtuar për mese emalit zyrtar zyrës se prokurimi në Podujeve, ku të njëjtit kanë konfirmuar se ka ndodhë gabim teknik dhe nuk kemi pas tendencë ndaj OE ankues. Sido qe të jetë, ky gabim teknik nuk ka efekt në çështjen e vlerësimit të ofertave dhe arsytet e eliminimit të OE ankues”.

Prandaj në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, sqarimeve dhe provave të bashkangjitura si më lartë, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa autoritetit kontraktues të vazhdoj tutje.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK ka deklaruar se pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa operatori ekonomik ankues ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimet në raportin e ekspertit shqyrtues.

Gjetjet e Panelit Shqyrtues

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues pa nevoj që të njëjtat të përshkruhen sërish në detaje.

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve

ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore rievlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, natyrisht se secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit. Andaj Paneli Shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së “*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*” kur ka refuzuar ofertën e OE ankues si të papërgjegjshme ngase Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive me ndërjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat duke pasur parasysh edhe rekomandimin e ekspertes shqyrtuese. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore konform nenit 59 të LPP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me lëndë djegëse -Peletë” me nr. të prokurimit 615-23-6669-1-1-1, pasi që referencat dhe kontrata e prezantuar nga operatori ekonomik ankues rezultojnë të gjitha “furnizime me derivate të naftë” dhe nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme sipas kërkesës së AK-së. Andaj, OE ankues në këtë rast nuk ka ofruar argumente bindëse që do të ndryshonte vendimin e AK, po ashtu ky aktivitet i prokurimit edhe po të kthehet serish në rivlerësim nuk do ndryshonte rezultatin pasi që OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat e kapaciteti teknik dhe profesional.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 dhe 4 lidhur me nenin 103 dhe nenin 117 të LPP për zbatim të procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë të drejtë pa diskriminim me qëllim të zgjedhjes së ligjshme dhe efektive të lendes. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP të cilat parashohin dhe rregullojnë situatat e tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktivitetit të prokurimit. Lidhur me tarifën ankimore është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga se u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PODUJEVËS**
- **OE - Bek Fluids L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: